

STATUTI  
I  
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

**"TECH-WEB " SH.P.K**

---

Ne baze te ligjit nr. 9901 dt. 14.04.2008 " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare"  
"UNE" ortaku i poshteshenuar :

**1- SANTO KURTI** atesia Bujar lindur me dt.11.04.1992 ne Tirane, dhe banues ne adresen "5 maji Tirane, Shqiperi, madhor e me zotesi te plete per te vepruar, e identifikuar me pasaporten BI8883992 nr. dhe numer personal J20411063G me vullnetin tim te lire e te plete themeloj me ane te ketij statusi shoqerine "**TECH-WEB" SH.P.K** me 1-(nje-ortak) sipas dispozitave ligjore te shprehura me poshte ne baze te ligjit 9901 Dt.14.04.2008.

**KREU I**

THEMELIMI, EMRI,OBJEKTI, KOHEZGIJATJA, SELIA, ADRESA NE INTERNET

**Neni 1**

**Themelimi dhe Emri i Shoqerise**

Sot ne date 02/02/2022, ne Tirane, "UNE" ortaku i lartpermendur kam themeluar shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar "**TECH-WEB" SH.P.K** me 1-(nje-ortak) me SELI QENDRORE ne adresen "**Tirane Pazari i ri , NR.PASURISE 13/4, ZK.8360, VOL 96, FQ 103 Tirane-Shqiperi.**"

**Neni 2**

**Objekti i Shoqerise**

Shoqeria tregtare "**TECH-WEB" SH.P.K** , do te kete si objekt te veprimtarise se saj : Tregeti e pajisjeve elektronike, perqatitja e skemave elektrike dhe kompiuterike, krijimi I faqeve web, marketing ne rrjetet sociale, shitja e pajisjeve kompiuterike, krijimi I llogarive ne rrjetet sociale dhe mirembajtjen e tyre, reklamim ne rrjete sociale te rekrutimit te punonjesve komunikimit online dhe te krijimit te desing digital, shitje , blerje online etj.

**Neni 3**

**Kohezgjatja e Shoqerise**

Shoqeria do te kete nje afat te papercaktuar ne veprimtarine e saj . Personalitetin juridik shoqeria e fiton pas rregjistrimit ne QKB , date e cila do shenoje dhe fillimin e veprimtarise se saj.

**Neni 4**

**Selia qendrore , vendi dhe adresa e Internetit**

Selia qendrore e shoqerise, me te cilin do te pajiset me Nipt/Nuis kryesor nga Qkb-ja, do te jete ne adresen adresen: "**Tirane , "Tirane Pazari i ri , NR.PASURISE 13/4, ZK.8360, VOL 96, FQ 103 Tirane-Shqiperi.**"

**" Tirane-Shqiperi.** Shoqeria ne baze te ligjit ka te drejte te hape zyra perfaqsimi ose dege te saj ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte vendit, duke ju nenshtruar legjislacionit te vendit perkates. Shoqeria gjate veprimtarise se saj ka te drejte qe te kete maredhenie edhe me shoperi te tjera shqiptare ose te huaja, brenda dhe jashte vendit, te beje bashkepunime me to ne baze te ligjeve shteterore dhe atyre nderkombetare. Shoqeria ka dhe adresen e saj ne internet qe eshte santo.kurti@gmail.com



KREU II  
Neni 5  
**Kapitali i Rregjistruar i Shoqerise**

Kapitali i rregjistruar i shoqerise eshte 100,000 (njeqind-mije) leke dhe perbehet nga "1" (nje) kuote/pjese. Ortaku i shoqerise zoteron "1" kuote dhe kapitali i shoqerise zoterohet teresisht nga 1-ortak. Ortaku i vetem Santo Kurti qe zoteron "1-nje kuote 100% te kapitalit themeltar te shoqerise dhe ka kontribuar me 100,000(njeqind mijë) Pas rregjistrimit ne QKB dhe fitimit te personalitetit juridik, shoqeria ka te drejt te perdore kapitalin e rregjistruar per fillimin e veprimtarise se saj. Shoqeria mund te marre hua financiare nga ortake, ose persona te trete fizik ose juridik institucion Bankare vendas ose te huaj, ne perputhje me ligjin e brendshem ose ate nderkombetar, per te plotesuar vleren financiare nese kapitali finanziar eshte i pamajftueshem per fillimin e aktivitetit.

Neni 6

**Certifikata dhe rregjistri i KUOTAVE**

Ortaku/ket themelues , sipas kontributit ne kuotat e kapitalit themeltar pajisen me Certifikaten e Kuotave leshuar nga shoqeria menjehere pas fitimit te personalitetit te saj juridik pas rregjistrimit ne QKB. Kuotat e shoqerise rregjistrohen ne "Rregjister" me vleren e tyre, rregjister qe administrohet nga administratori i shoqerise gjate gjithe mandatit te tij ligjor te vendosur ne ligj dhe ne kete Statut . Ne kete rregjister behen shenimet perkatese ne rast te tjetersimit teresisht ose pjeserisht te koutave te kapitalit themeltar te shoqerise ose kur kouta te caktuara zoterochen bashkarisht nga disa ortak.

Neni 7

**Kalimi i KUOTAVE**

Kalimi ose tjetersimi i kuotave te kapitalit themeltar te rregjistruar te shoqerise mund te behet me anen e shitblerjes , dhurimit, trashegimit ose cdo menyre tjeter te perashikuar ligjerisht. Ne rastet e shitblerjes apo dhurimit nenshkuhet kontrata perkatese ne baze te dispozitave ligjore. Kur shoqeria zoterohet me dy ose me shume ortak, Secili prej ortakeve eshte i detyruar te marre pelqimin e ortakut tjeter para se te bez kalimin e pjeses se tij te kuotave tek nje person tjeter fizik ose juridik qe pretendon te hyje si ortak i ri ne shoqeri. Ne rastet kur nje ortak vdes, atehere kuotat e tij trashegojen ne baze te ligjit per shoqerite tregtare dhe te dispozitave ligjore per trashegimine nga pasardhesit e tij sipas radhes ligjore ose testamentit. Trashegimtari i kuotave pasi i ka paraqitur administratorit dokumentat provuese si trashegimtar, ka te drejt te kerkoje nga administratori rregjistrimin e emrit te tij si ortak ne rregjistrin e kuotave te shoqerise. Sido qe te jete menyra e kalimit te kuotave, Administratori ne cdo rast ben shenimet perkatese ne rregjistrin e aksioneve.

Neni 8

**Zmadhimi ose zvoglimi i kapitalit te shoqerise**

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit. Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë. Asambleja e Ortakeve merr vendimin perkates ne baze te dispozitave te ligjit tregtar, ku vendos per shumen me te cilin do te rritet kapitali dhe autorizon administratorin te ndjeje te gjitha procedurat ligjore per kete qellim. Zvogëlimi i kapitalit



lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Zvoglimi i kapitalit te shoqerise behet me vendim te asamblese dhe ne cdo rast jo me pak se 100.000(njeqind- mijë) leke sipas kushteve ligjore te parashikuara ne ligj. Ne cdo rast zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit behet me një raport te detajuar te eksperpit kontabel dhe rregjistrohet ne QKB. Asambleja e ortakeve vendos per rritjen apo zvoglimin e kapitalit mbasi eshte konsultuar me ekspertin kontabel ne baze te një raporti te detajuar te tij, si dhe me administratorin.

**KREU III**  
**ORGANET DREJTUESE**  
**Asambleja , Administratori/et**  
**Neni 9**  
**Asambleja**

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise. Asambleja e ortakeve, mblidhet ne menyre te zakonshme te pakten 2-here ne vit. Mbledhja thirret nga te pakten njeri prej ortakeve ose nga administratori. Njoftimi behet te pakten 7-dite para dates se caktuar per mbledhje me ane te faxit, telefonit fix apo cel, e-mailit, postes etj.

Asambleja (ortaku) merr vendime dhe ka kompetencia per :

- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve; per investime;
- vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- ndryshimet e statutit;
- emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- përcaktimin e shpérblimeve për personat e përmendur me lart
- mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ne raste te caktuara kur nje nga ortaket mungon ai mund te perfakesohet sipas rregullave ligjor te perfakesimit nga nje person i zgjedhur prej tij.

**Neni 10**  
**ADMINISTRATORI**

ADMINISTRATORI i emeruar i shoqerise me vendim unanim te asamblese se ortakeve eshte Zoti **Santo Kurti**. Afati i emerimit te tij eshte 3-vite me te drejte rizgjedhjeje. Ky afat fillon ne date 02/02/2022 dhe mbaron ne date 03/02/2025. Administratori emerohet dhe shkarkohet me shumice votash nga asambleja e ortakeve. Administratori ka të drejtë dhe detyrohet qe të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqerinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;



ç) përgatit dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raporton përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare, kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori i shoqerise ka te drejte te kryeje veprime financiare ne te gjitha Bankat ku Shoqeria ka llogari Bankare. Administratori ne baze te ligjit mund te delegoje një ose disa kompetencia te veprimtarise se tij tek një person tjeter me ane te autorizimit ose prokures, pasi te kete marre pelqimin e shumices se thjeshte te asamblese se ortakeve. Cdo veprim i tij ne kundershtim me kete dispozite e ngarkon administratorin me perjegjesi ligjore.

Administratori eshte personi qe perfaqeson shoqerine me te tretet dhe specimenti i nenshkrimit te tij eshte si me poshte :

Specimenti /nenshkrimi (emer , mbiemri, firme)

Santa Kuci:



### Neni 10

#### Emerimi I ekspertit kontabel

Asambleja e shoqerise cakton një ose disa eksperte kontabel që mund te jene persona fizik ose juridik, ne rastet e kerkuara nga ligji. Mandati I ekspertit kontabel eshte 3-vjet me te drejte rizgjedhjeje. Emerimi dhe largimi I ekspertit behet me vendim te asamblese me shumice te thejshte. Eksperti kontabel ka detyrimin te raportoje ecurine finaciare te shoqerise dhe te beje sugjerime per rentabiliteten e veprimtarise se shoqerise. Eksperti kontabel ka te drejte te beje kontolle periodike te aktivitetit te shoqerise dhe te raportoje per keto tek ortaket ose administratori. Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1- Janar dhe perfundon me 31 -Dhjetor. Perjashtmisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbylljet me 31 Dhjetor. Eksperti kontabel mban një raport te detajuar ne mbylljen e vitit ushtrimor fiskal dhe eshte perjegjes per mbylljen e bilancit te shoqerise dhe ndarjen e dividentit. Dividendi shpërndahet mes ortakeve, në raport me vlerën e kapitalit të regjistruar, dhe kuotat e secilit ortak.

### Neni 11

#### Dividentet dhe shperndarja e tyre.

Shperndarja e dividentit behet pas raportit finanziar te ekspertit per mbylljen e vitit ushtrimor finanziar , bilancit. Shperndarja behet me vendim te ortakut ose te asamblese ne perputhje me ligjin . Shperndarja e dividentit behet ne raport me pjesmarrjen e ortakut-ve ne kuotat e kapitalit te rregjistruar. Nje pjese e dividentit te pashperndare , me vendim te asamblese mund te kaloje ne kapitalin themeltar.



**Neni 12**  
**Riorganizimi , Prishja dhe likujdimi I shoqerise**

Shoqeria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi, prishja e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, sipas neneve 190 deri në 205 të ligjit 9901 dt. 14.04.2008 "Per Tregetaret dhe Shoqerite tregtare" Ne rastet e prishjes dhe te likuidimit te shoqerise para afatit te mesiperm vendos mbledhja e pergjithshme e asamblese se ortakeve. Likujduesi mund te shperndaje te ortaku-et te gjitha pasurite e deri ne ate moment qe posedon ne pronesi shoqeria. Prishja mund te vije edhe si pasoje e falimentimit te shoqerise. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga asambleja e ortakeve ose ortaku i vetem. Nëse asambleja nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues. Likuiduesi emerohet nga Gjykata ne rastet kur shoqeria prishet me vendim gjykate. Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Pas shlyerjes së detyrimeve ndaj kreditorëve, likuiduesi u shpërndan ortakut-ve aktivet e mbetur, sipas të drejtave që ata kanë në ndarjen e fitimeve, Pas shpëndarjes së aktiveve të mbetur, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë.

**Neni 13**  
**Dispozita te Fundit**

Ky "Statut" eshte mbeshtetur teresisht ne ligjin 9901 dt. 14.04.2008 "Per Tregetaret dhe Shoqerite tregtare". Per te gjitha rastet te cilat nuk jane parashikuar ne statut do te gjejne zgjidhje dhe interpretohen sipas ketij ligji. Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Kompetente Shqiptare.

"Statuti" eshte perpiluar ne 4-kopje origjinale me fuqi te njejtë ligjore, ne gjuhen SHQIPE sipas kerkesave te ligjit. Permbajtja e STAUTIT pasi lexohet dhe kuptohet perfundimisht mesemiri nga ORTAKU/ ortaket e shoqerise, gjendet ne perputhje me vullnetin e tone te plete dhe ortaku/et e sipershenuar e nenshkruajme pa asnje verejtje.

**THEMELUESIT E SHOQERISE "TECH-WEB" SH.P.K  
SANTO KURTI**

Santo Kurki  


**emer mbiemer me shkrim dore + firma**

---